



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 28**

**Datë: 06. 10. 2023. Ora: 13:30**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

**Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.**

**Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.**

---

**R ENDI I DITËS**

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të KQZ-së nr. 26 dhe 27/2023.
3. Aktivitetet e Zyrës:
  - Rekomandim për regjistrimin e partisë politike “Shpresa Demokrate”
4. **Raportet e Këshillave të KQZ-së:**
  - 4.1.Këshilli për Operacione Zgjedhore
    - Shqyrtimi dhe miratimi i kompozimit të melodisë së KQZ-së,
    - Shqyrtimi dhe miratimi i draft-projektit "Informimi dhe Edukimi i Votuesve të Rinj".
  - 4.2.Këshilli për Buxhet dhe Financa
    - Shqyrtimi dhe miratimi i kërkeses për aktivitetin e prokurimit ‘Transporti ajror’
    - Shqyrtimi dhe miratimi i specifikave për servisimin e veturës BMË për tu përfshirë ne planin e prokurimit
    - Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të vlerësimit të pasurisë jo financiare,
  - 4.3.Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë

-Shqyrtimi dhe miratimi i ftesës për pjesëmarrje e kryetarit të KQZ dhe Zyrës, në Pragë

-Shqyrtimi dhe miratimi i ftesës e KQZ\_së së Shqipërisë, për pjesëmarrje e KQZ-së në konferencë

## 5. Të ndryshme

---

### 1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Kryetari Radoniqi e hapi mbledhjen dhe paraqiti agjendën e mbledhjes, ndërsa që anëtari Alban Krasniqi, ftoi anëtarët e KQZ – së për një minutë heshtje në nderim të rreshterit Afrim Bunjaku, i cili u vra në Banjsko në konfrontim me një grup të armatosur serb që kishte hyrë ilegalisht në Banjsko. Krasniqi, tha se Bunjaku ra duke mbrojtur rendin, ligjin dhe shtetin.

Në vazhdim, **Arianit Elshani** kërkoi që pika në kuadër të KOZ-it të jetë pas Këshillit për Buxhet për shkak të miratimit të “melodisë së KQZ-së”, e cila teknikisht duhet edhe të dëgjohet nga anëtarët për mriatim.

Pas miratimit të agjendës me 9 vota për dhe me 1 abstenim, anëtarët e KQZ –së miratuan procesverbalet e mbledhjeve paraprake nr. 26 dhe 27/2023.

Ende pa filluar shqyrtimi i pikave të rendit të ditës, z. Sami Kurteshi ia shtroi një pyetje kryeshefit duke i thënë se “në cilën cilësi, është në mbledhje të KQZ –së”...?

**Burim Ahmetaj**, tha se në mbledhje është sipas vendimit të mbledhjes së 18 shtatorit 2023.

**Sami Kurteshi**: A jeni i bindur se ai vendim është i ligjshëm...? Dhe të njëjtën pyetje, e shtroi edhe për anëtarët e KQZ-së, due shtuar nëse baza ligjore ka qenë në rregull, pra “cila ka qenë baza ligjore” ?

**Ilir Gashi**: Mendoj që ndoshta kryetari përgjigjet, por nëse jo kërkojë që të mos hyjmë edhe njëherë në këtë çështje dhe kushdo që ka diçka lidhur me kryeshefin, mund tu drejtohet organeve gjyqësore, gjykatave... Pra, le ta kontestoj vendimin e KQZ-së...! Nëse kërkoni nga unë, madje s’ka problem e nënshkruj edhe unë...Kështu, nuk kemi çka i shtojmë tjetër këtij procesi...

**Sami Kurteshi**: Megjithatë, unë ju pyeta se cila është baza ligjore, ku jeni bazue...?

**Sami Hamiti**: Ne, jemi bazue diku, por unë nuk kam nevojë me të dhënë përgjigje...

**Sami Kurteshi**: Pra, unë them se vendimi është i paligjshëm, totalisht i kundërligjshëm sepse, vota demokratike kërkon edhe procedura. Vendimi është i kundërligjshëm sepse ligji për zgjedhje që ka hy në fuqi në korrik të këtij viti, nuk e njeh funksionin e kryeshefit të KQZ-së. Në mënyrë shprehimore, nuk e njeh ligji....! Nuk e njeh, por thotë me e zgjedh një drejtor, tash në cilën cilësi, a është drejtor...? Z. Ahmetaj, ju jeni zyrtari kryesor administrativ që ju kanë zgjedh me e mbrojte ligjshmërinë, jo për tjetër...Dhe, ju u kanë dhënë funksion që nuk ekziston...!

Më fal, a ekziston...? Nuk ekziston...!

Në vazhdim, u shkaktue polemikë në mes të Ilir Gashit dhe Sami Kurteshit, pastaj edhe mes tij dhe Gordana Llabanit, mes Ilir Gashit dhe Alban Krasniqit etj. Diskutimet nuk kishin rend, dhe kjo qoi në konfuzitet të diskutimeve...

Kryetari **Radoniqi**, tha mbasandaj lidhur me pyetjen e shtruar nga z. Kurteshi se “janë mbajtur dy mbledhje, është diskutuar mandati. Në mbledhje e dytë, ka qenë kjo: ishin, dy propozime. Propozimi im nuk kaloi dhe mori vetëm 4 vota, kurse propozimi i z. Ibrahim Selmanaj kaloi me 7 vota. E kemi një vendim që, prapë mendoj se është i kundërligjshëm por, unë nuk jam gjykatë, ne nuk jemi gjykatë. Ju lutem vazhdojmë tutje, kemi disa punë ti kryejmë...Këto çështje, i vendos gjykata. Ne jemi organ kolegjal me të drejtë të votës...

**Alban Krasniqi**: Në të njëjtën thua që është vendim i paligjshëm, dhe në të njëjtën kohë thua të presim gjykatën...

**Kreshnik Radoniqi**: Unë mendoj kështu...Ne, nuk e vendosim ligjshmërinë. Mandati nuk buron nga ligji por nga vota. Nëse duam me bllokue punën e KQZ-së...

**Alban Krasniqi**: Ky mund të jetë kryeshef i juaji, ky që ju bënë favore por, nuk mund të jetë kryeshef yni... Në vazhdim, pati polemika të cilat, nuk janë të përshtatshme të futen në procesverbal...